



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.03.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të efikasitetit energjetike, faza III”” (*Komision për dhënie mendimi*)

Projektligji “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Fadil Nasufi dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmir Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli Lorenc Luka, Robert Bitri, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Ilir Bejtja – zëvendesministër i Energjisë dhe Infrastrukturës

Agim Bregasi – drejtor MEI

Alfred Bundo – drejtor MEI

Fatos Bundo - drejtor KESH

Ardian Islami - përgjegjës sektori KESH

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëdita!

Sot kemi dy projektligje për shqyrtim. Projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të efikasitetit energjetike, faza III””, me relatore zonjën Eglantina Gjermeni.

Dhe projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008” me relator zotin Besnik Baraj.

Të ftuar kemi zotin Bejtja, zëvendesministër i Energjisë dhe Infrastrukturës, si dhe z. Bundo, po nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, dhe z. Bundo dhe z. Islami nga Kooroprata Energjetike Shqiptare.

Ju falënderoj për ardhjen tuaj këtu!

Ju ftoj të bëni një prezantim të shkurtër. Më pas çdo anëtar komisioni është i lirë të bëjë pyetjet përkatëse.

Ilir Bejtja – Mirëdita të nderuar deputetë.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të efikasitetit energjetike, faza III.

Nëpërmjet marrëveshjes që propozohet për ratifikim, të dyja qeveritë bien dakord për akordimin e një granti nga qeveria gjermane, me vlerën deri në 2 927 765,96 euro, për zbatimin e fazës së tretë të projektit. Ky financim i cili do të vihet në dispozicion nëpërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) dhe është planifikuar të fillojë disbursimin brenda vitit 2019. Detajet e disbursimit të fondeve grant do të përcaktohen më pas në marrëveshjen financiare që do të lidhet mes palëve.

Projekti, që do të financohet nëpërmjet këtij granti është parashikuar në programin buxhetor afatmesëm 2019-2021” të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin “Mbështetje për energjinë”.

Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të efikasitetit energjetike synon rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës,

në funksion të rritjes së efikasitetit të energjisë dhe të kushteve të përshtatshme të studentëve, duke aplikuar masat e efikasitetit të energjisë në godinat e konvikteve, sipas objektivave:

Auditim energjetik i ndërtesave për të identifikuar konsumin e energjisë dhe masat përkatëse që duhen për të reduktuar konsumin e energjisë;

Identifikim i nevojave të rinovimit të ndërtesave në lidhje me gjendjen aktuale të tyre për të zgjatur ciklin e jetës së ndërtesave;

Identifikim i masave të ndryshme të efikasitetit të energjisë që mund të aplikohet, si dhe llogaritja e kursimit të energjisë në secilën prej godinave, me qëllim përcaktimin e kriterëve dhe të masave të efikasitetit të energjisë me një kosto të lartë përfitimi;

Reduktim i konsumit të përgjithshëm të energjisë së ndërtesave, duke synuar që treguesi i performancës së energjisë të jetë të paktën 75 kwh/m² në vit dhe të sigurojë përmirësimin e kushteve të jetesës së studentëve;

Llogaritjen e reduktimit të karbonit si rezultat i masave dhe vendosjes në kushte të performancës së lartë (sipas synimit të mësipërm 75 kwh/m²vit) dhe të standardeve të Bashkimit Evropian.

Projekti përfshin rehabilitimin e konvikteve nr.3, 14, 16, 17 dhe 18, në varësi të buxhetit në dispozicion, sipas përcaktimeve në marrëveshjet financiare tashmë të dakordësuara me KfW, në lidhje me financimet në vlerat prej 4 500 000 eurosh (faza I) dhe 2 032 179.23 eurosh (faza II), si dhe, mundësisht, rehabilitimin e dy – katër godinave të tjera konviktesh.

Nëpërmjet marrëveshjes që propozohet për miratim, synohet akordimi i një granti nga qeveria gjermane, me vlerën deri në 2 927 765,96 euro, i cili vihet në dispozicion nëpërmjet Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) dhe do të përdoret për zbatimin e fazës së tretë të projektit.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit!

Ka pyetje nga anëtarët e komisionit? Nuk ka pyetje.

E falënderojmë zotin Bejtja për prezantimin!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës, sipas parimit të efikasitetit energjetike, faza III””.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është dakord?

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.03.2019, ora 10:50

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008”
(Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Fadil Nasufi dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli Lorenc Luka, Robert Bitri, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Ilir Bejtja – zëvendesministër i Energjisë dhe Infrastrukturës

Agim Bregasi – drejtor MEI

Alfred Bundo – drejtor MEI

Fatos Bundo - drejtor KESH

Ardian Islami - përgjegjës sektori KESH

Niko Peleshi – Vazhdojmë me rendin e ditës.

Projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008”. Relator zoti Besnik Baraj.

Ju ftoj të bëni një prezantim të shkurtër. Më pas çdo anëtar komisioni është i lirë të bëjë pyetjet përkatëse.

Besnik Baraj - Projektligji “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit për projektin “Siguria e digave”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008.

Letërmarrëveshja ndryshuese përfaqëson komunikimin e Bankës Botërore, e cila njofton që, në mënyrë unilaterale, rialokon pjesën e mbetur të pashfrytëzuar, nga kategoria 3 e projektit në kategorinë 2 të tij, në funksion të shërbimeve të konsulencës së zbatimit për këtë projekt.

Projektligji është hartuar si rezultat i bashkëpunimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe KESH, sh.a.-së, ndërsa letërmarrëveshja ndryshuese është përcjellë në mënyrë unilaterale nga Banka Botërore.

Projekti “Siguria e digave” është në kuadrin e programit për komunitetin e energjisë së Evropës Juglindore. Ky projekt ka si objektiv:

Rritjen e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të sistemit elektroenergetik shqiptar në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat;

Rritjen e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të efikasitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e qëndrueshme të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në tregun rajonal të energjisë.

Përmes kësaj letërmarrëveshjeje synohet:

Financimi i konsulentit të zbatimit të projektit për detyra të cilat janë përfshirë në kategorinë 2 të marrëveshjes, por për shkak të punimeve shtesë të evidentuara në

rehabilitimin elektromekanik të HEC-it Koman, kërkon financim shtesë për supervizionin shtesë të punimeve rehabilituese elektromekanike të agregateve në HEC-in Koman. Gjithashtu, fonde të lira të angazhuara në kategorinë 3, në shumën 300 000 euro, do të kalohen në kategorinë 2, “Shërbimet e konsulentëve”, me qëllim mbulimin e kostove për supervizionin e punimeve dhe financimin e panelit të pavarur të ekspertëve për projektin “Siguria e digave”.

Shtyrja e datës së mbylljes deri më 31.12.2020 pasi për realizimin e punimeve shtesë do të duhet kohë shtesë dhe për këtë arsye bëhet e domosdoshme shtyrja e datës së mbylljes së kredisë.

Niko Peleshi – Shumë faleminderit!

Ka pyetje nga anëtarët e komisionit? Nuk ka pyetje.

E falënderojmë zotin Bejtja për prezantimin!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.9965, datë 24.7.2008”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është dakord?

Miratohet.

Zoti zëvendesministër, shumë faleminderit! Punë të mbarë dhe suksese!

Falënderoj edhe anëtarët e komisionit!

MBLEDHJA MBYLLET